

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Ramë Hyseni dhe Isa Shala anëtarë, në çështjen juridike të paditësve H.,L.,V.,M.,A.,S.,dhe I.D., të gjithë nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës, të cilën sipas autorizimit i përfaqëson J.R., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë, të cilën sipas autorizimeve e përfaqësojnë B.F. dhe O.K., jurist, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesat e të autorizuarve të palëve, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr.2459/09 të datës 23.02.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **11.03.2016**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHEN si pjesërisht të themelta ankesat e të autorizuarit të paditësve dhe e të autorizuarit të paditurës, **NDRYSHOHET** nën paragrafin I, III dhe IV dispozitivi i aktgjykimit i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.2459/09 i datës 23.02.2012, dhe gjykohet si vijon: **Pjesërisht** aprovohet kërkesëpadia e paditësve H.,L.,V.,M.,A., dhe S.D., të gjithë nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës, ashtu që:

OBLIGOHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë që paditësve për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes, për dëmin jo material dhe material si vijon:

- a) Paditësës H.D., ti paguhet shuma prej 5.000,00€, (pesëmijë euro), si dhe shuma prej 600,00€ (gjashtëqind euro) për shpenzimet e varrimit dhe shumën prej 1.500,00€ (njëmijë e pesëqind euro) për ngritjen e lapidarit,
- b) Paditësës L.D., ti paguhet shuma prej 4.000,00€,(katërmijë euro),
- c) Paditësit V.D., ti paguhet shuma prej 4.000,00€,(katërmijë euro),
- d) Paditësës M.D., ti paguhet shuma prej 4.000,00€, (katërmijë euro),
- e) Paditësës A.D., ti paguhet shuma prej 4.000,00€,(katërmijë euro) dhe
- f) Paditësit S.D., ti paguhet shuma prej 4.000,00€,(katërmijë euro),

II.1 REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve H.,L.,V.,M.,A., dhe S.D. për tej pjesës së aprovuar sikurse nën paragrafin I të këtij aktgjykimi me të cilën kanë kërkuar të detyrohet e paditura të ju paguan në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes a) Paditësës H.D., ti paguhet shuma prej 2.000,00€,(dymijë euro), si dhe shuma prej 400,00€ (katërqind euro) për shpenzimet e varrimit, b) Paditësës L.D., ti paguhet shuma prej 3.000,00€, (tremijë euro), c) Paditësit V.D., ti paguhet shuma prej 3.000,00€,(tremijë euro), d) Paditësës M.D., ti paguhet shuma prej 3.000,00€,(tremijë euro), e) Paditësës A.D., ti paguhet shuma prej 3.000,00€,(tremijë euro) dhe f) Paditësit S.D., ti paguhet shuma prej 3.000,00€,(tremijë euro),

II.2. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve A. dhe I.D., të dy nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës me të cilën kanë kërkuar të detyrohet e paditura të ju paguan paditësit A.D., shumën prej 5.000,00€ (pesëmijë euro) dhe paditësit I.D. shumën prej 5.000,00€ (pesëmijë euro), në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes - vëllait.

III. OBLIGOHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë që paditësve të paguaj shumat e gjykuara, si dhe ti paguajë kamatën të cilën bankat afariste në Kosovë, e paguajnë për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar mbi një (1) vit, duke filluar nga data 17.04.2007 e deri në pagesën definitive, sa i përket shumave të gjykuara si në pikën **I.** të këtij aktgjykimi dhe nga data 01.09.2011 deri në pagesën definitive, për shumat e gjykuara në pikën **II.** të dispozitivit të aktgjykimit C.nr.2459/09 i datës 23.02.2012, të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

IV. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.2459/09 i datës 23.02.2012 përkitazi me pikën **II.** të dispozitivit, sa i përket rentës, si dhe pikën **III.** që i referohet vendimit mbi shpenzimet e procedurës dhe në këtë pjesë aktgjykimi **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2459/09 të datës 23.02.2012, në pikën një të dispozitivit të aktgjykimit pjesërisht e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësve H.,L.,V.,M.,A.,S.,dhe I.D., të gjithë nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës dhe detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material për shkak të vdekjes së familjarit në fatkeqësi komunikacioni të shkaktuar me datë 23.08.1993, tua paguajë dhe atë: paditëses H.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së bashkëshortit shumën prej 2.500 euro, në emër të shpenzimeve të varrimit shumën prej 600 euro, për ngritjen e lapidarit shumën prej 1.500 euro, paditëses L.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së babait shumën prej 2000 euro, paditësit V.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së babait shumën prej 2000 euro, paditëses M.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së babait shumën prej 2000 euro, paditëses A.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së babait shumën prej 2000 euro, paditësit S.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së babait shumën prej 2000 euro, paditësit A.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së vëllait shumën prej 1000 euro, paditësit I.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së vëllait shumën prej 1000 euro. Në pikën dy të dispozitivit detyrohet e paditura që paditëses A.D. në emër të rentës për periudhën prej datës 01.09.1999 e deri me datë 30.09.2006, t'ia paguajë shumën prej 8.107 euro, ndërsa paditësit S.D. në emër të rentës për periudhën prej datës 01.09.1999 e deri me datë 31.08.2011, t'ia paguaj shumën prej 18.708 euro. Në pikën tre të dispozitivit detyrohet e paditura që paditësve shumat e gjykuara në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'ua paguaj me kamatë prej 3.5%, që nga data 17.04.2007, e deri në paguarjen definitive si dhe t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.831 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga dita e

marrjes së aktgjykimit në dorëzim me kërcënim të përmbarimit forcërisht, ndërsa në pikën katër të dispozitivit ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve mbi shumat e gjykuara dhe atë: paditëses H.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së bashkëshortit në shumë prej 4.500 euro, në emër të shpenzimit të varrimit në shumë prej 400 euro, paditëses L.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për vdekjen e babait në shumë prej 5000 euro, paditësit V.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për vdekjen e babait në shumë prej 5000 euro, paditëses M.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për vdekjen e babait në shumë prej 5000 euro, paditëses A.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për vdekjen e babait në shumë prej 5000 euro, paditësit S.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për vdekjen e babait në shumë prej 5000 euro, paditësit A.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për vdekjen e vëllait në shumë prej 4000 euro dhe paditësit I.D. në emër të dhembjeve shpirtërore për vdekjen e vëllait në shumë prej 4000 euro.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësve në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe për paditësit të caktoj shuma adekuate për dhembjet shpirtërore si dhe të obligoj të paditurën që ta paguaj shpenzimet e procedurës ankimore.

Kundër këtij aktgjykimi të autorizuarit e të paditurës në afat ligjorë kanë paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, me propozim që të aprovohet ankesa e Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a, si e bazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.2459/09 i datës 23.02.2012, ndryshohet me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve si e pabazuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK dhe gjeti se:

Ankesat janë pjesërisht të themelta

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit kanë ushtruar padi kundër të paditurës për kompensim dëmi material dhe jo material, për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes në aksidentin hekurudhor të datës 23.08.1993. Paditësit fillimisht padi kanë ushtruar sipas lëndës C.nr.428/96 kundër të paditurës Ndërmarrja për Transportimin e udhëtarëve “Auto Transport” D.O.O., në Obiliq, ndërsa është aktivizuar sipas aktvendimit mbi lejimin e përtëritjes së shkresave të lëndës C.nr.428/96 të datës 27.12.2002, nxjerrë nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Paditësit përmes precizimit të padisë kanë bërë ndryshimin e palës së paditur ashtu që si të paditur kanë paraqitur Korporatën Energjetike të Kosovës me seli në Prishtinë.

E paditura Korporata Energjetike e Kosovës ka kontestuar legjitimitetin e saj si palë e paditur, duke pretenduar se Ndërmarrja për Transportin e udhëtarëve “Auto Transport” D.O.O., në Obiliq, ka qenë ndërmarrje e pavarur e kontraktuar nga e paditura për transportin e punëtorëve, ndërsa i ndjeri ka qenë vetëm punëtorë i saj i EEK-së.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditëseve ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar duke u bazuar në dispozitat e nenit 193.1, 194, 200 dhe 201 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vlerësimet juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullta dhe të bazuara në ligj pjesërisht i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vështron sipas detyrës zyrtare, po ashtu nuk ekzistojë shkelje esenciale të cilat i pretendon pala e paditur.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë rregullisht dhe në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes në këtë çështje juridike.

Mirëpo, për kundër këtyre fakteve, gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, përkitazi me aspektet e dëmit jo material.

Në bazë të shkresave të lëndës dhe atë procesverbalit KI.br.132/93 i datës 23.08.1993, nga vendi i ngjarjes i përpiluar nga gjyqtari hetues i Gjykatës Komunale në Prishtinë, është vërtetuar fakti se ka ndodhur aksident, ku autobusi i punëtorëve në vendkalimin e binarëve të trenit afër fshatit Pomazetin është aksidentuar me trenin i cili ka qarkulluar në relacionin Fushë Kosovë-Pejë, në të cilin aksident ka humbur jetën i ndjeri S.D., për shkak të vdekjes të cilit anëtarët e familjes kanë parashtruar kërkesë për kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Gjykata e Apelit me rastin e vlerësimit të aktgjykimit të shkallës së parë, respektivisht pikës I të dispozitivit për paditësit H.,L.,V.,M.,A., dhe S.D., të cilët kanë pasur raport bashkëshorte dhe fëmijë të ndjerit, si dhe paditësve A. dhe I.D. të cilët kanë qenë vëllezër të të ndjerit, ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale-neni 200 paragrafi 2 dhe 201 të LMD-së¹, në rastin e vlerësimit të shumave të gjykuara për paditësit H.,L.,V.,M.,A., dhe S.D., pasi shumat e gjykuara si në aktgjykimin e atakuar në pikën I, kanë qenë të ulëta dhe jo në përputhje me qëllimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar për shkak të dhembjeve shpirtërore për vdekjen e anëtarit të familjes.

Në bazë të kriterëve dhe masave për përcaktimin e lartësisë së dëmeve jo materiale dhe llojeve të dëmeve jo materiale, lartësia e përcaktuar për këto aspekte të dëmit nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk është në përpjesëtim me dhimbjet e pësuar shpirtërore të paditësve për vdekjen e bashkëshortit dhe babait. Në të vërtetë në bazë të nenit 201 par. 1 të LMD-së², shprehimisht parashihet se, në rast vdekje të ndonjë personi, gjykata mund të gjykojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit), kompensimin e drejtë në të holla në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes. Me paragrafin 2. të kësaj dispozite në këtë kompensim kanë të drejtë edhe vëllezërit dhe motrat në qoftë se midis tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme. Dhimbjet shpirtërore përfaqësojnë aspekt të dëmit jo pasuror dhe lartësinë e dëmit e përcakton gjykata sipas vlerësimit të vet të lirë e në bazë të nenit 323 të LPK-së. Gjykata e Apelit konsideron se

¹ LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978,

² Njëjtë,

lartësia e dëmit të gjykuar nga ana e gjykatës të shkallës së parë në emër të dhimbjeve shpirtërore është jo reale dhe për këtë arsye aktgjykimi i atakuar është ndryshuar dhe është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësve si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa është refuzuar si e lartë dhe që nuk është në përputhje me qëllimin e shpërblimit të dëmit si në pikën II.1. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e apelit vlerëson se është kompensimi i drejtë aprovimi i shumave për dëmin material në shumën prej 600,00€ (gjashtëqind euro) për shpenzimet e varrimit dhe shumën prej 1.500,00€ (njëmijë e pesëqind euro) për ngritjen e lapidarit e cila kërkesë bazohet në nenin 193 të LMD-së³, ndërsa është refuzuar kërkesa për shumën prej 400,00€ (katërqind euro) për shpenzimet e varrimit, si tepër e lartë dhe e pa bazuar.

Gjykata e Apelit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve A. dhe I.D., të dy nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës me të cilën kanë kërkuar të detyrohet e paditura të ju paguan paditësit A.D., shumën prej 5.000,00€ (pesëmijë euro) dhe paditësit I.D. shumën prej 5.000,00€ (pesëmijë euro), në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes – vëllait, pasi në bazë të shkresave të lëndës të njëjtit nuk kanë mundur ta vërtetojnë se kanë qenë në bashkësi familjare me të ndjerin me rastin e ndodhjes së aksidentit, që është kusht për të drejtën e shpërblimit të dëmit bazuar në nenin 201 paragrafi 2 të LMD-së⁴. Gjykata e Apelit nuk mund ta aprovoj qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë ku i ka njohur këtë të drejtë paditësve A. dhe I.D. në të drejtën për kompensimin e dëmit jo material për shkak të vdekjes së vëllait të tyre, në bazë të deklaratës së datës 22.02.2007, e dhënë në komunën e Fushë Kosovës, pasi kjo deklaratë është dhënë në bazë të dy dëshmitarëve, për të cilat deklarata komuna si organ zyrtar nuk ka asnjë përgjegjësi, por bënë vetëm verifikimin e nënshkrimeve, e njëjta është dhënë në vitin 2007, që do të thotë pas 14 viteve, në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë provë e cila do të provonte se paditësit A. dhe I.D., në momentin e aksidentit kanë qenë në bashkësi familjare me të ndjerin, provë e besueshme për të vërtetuar këtë rrethanë është certifikata mbi bashkësinë familjare, andaj në mungesë të provave edhe është refuzuar kërkesëpadia e tyre si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit duke vendosur si në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka obliguar të paditurën Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë që paditësve të i paguajë kamatën të cilën bankat afariste në Kosovë, e paguajnë për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar mbi një (1) viti, duke filluar nga data 17.04.2007 e deri në pagesën definitive, sa i përket shumave të gjykuara si në pikën I. të këtij aktgjykimi dhe nga data 01.09.2011 deri në pagesën definitive, për shumat e gjykuara në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit C.nr.2459/09 i datës 23.02.2012, të Gjykatës Komunale në Prishtinë, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së⁵.

Gjykata e Apelit si në pikën IV. të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka vendosur që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.2459/09 i datës 23.02.2012, përkitazi me pikën II. të dispozitivit, sa i përket rentës, si dhe pikën III. që i referohet vendimit mbi shpenzimet e procedurës dhe në këtë pjesë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

³ LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978,

⁴ Njëjtë,

⁵ Njëjtë,

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në pikën II të aktgjykimit të atakuar me të cilën ka obliguar të paditurën që paditëses A.D., në emër të rentës për periudhën prej datës 01.09.1999 e deri me datë 30.09.2006, t'ia paguajë shumën prej 8.107 euro, ndërsa paditësit S.D. në emër të rentës për periudhën prej datës 01.09.1999 e deri me datë 31.08.2011, t'ia paguajë shumën prej 18.708 euro, të cilin aktgjykim gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në bazë të ekspertizës së aktuarit A.B. të datës 01.09.2011, të cilin qëndrim në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë, pasi nga provat e administruara në shkresat e lëndës-certifikatat e lindjes, paditësit A.D. dhe S.D., në periudhën për të cilën i 'u është njohur e drejta e rentës kanë qenë të moshës së mitur, andaj kjo e drejtë u takon në bazë të nenit 194 të LMD-së⁶. Kështu gjykata e ka aprovuar edhe ushqimin e humbur në formë të rentës të kapitalizuar për periudhën e theksuar në dispozitiv e në bazë të nenit 203 të LMD-së⁷. Sa i përket pretendimeve ankimore të palës së paditur lidhur me lartësinë e rentës dhe bazës juridike për caktimin e saj gjykata e shkallës së dytë i konsideron të pa bazuara, për faktin se e paditura ka mundur që të kërkojë rrethana sqaruese nga eksperti financiar i cili ka qenë prezent në seancën e datës 23.02.2012, po ashtu ka mundur që të kërkojë ri ekspertizë në rast se nuk është pajtuar me ekspertizën e ekspertit financiar A.B. të datës 01.09.2011, të cilën kërkesë nuk e kanë parashtruar.

Gjykata ka vërtetuar vendimin sa i përket shpenzimeve të procedurës, pasi nuk ka pasur pretendime ankimore të specifikuar sa i përket vendosjes lidhur me shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit konsideron si të pa bazuar pretendimet ankimore të palës së paditur se nuk ka legjitimitetin e palës në procedurë, duke pretenduar se autobusi nuk ka qenë pronë e Elektro Ekonomisë së Kosovës dhe as i ish Elektro Ekonomisë së Serbisë, por ka qenë pronë e ndërmarrjes për bartjen e punëtorëve Auto Transport, shoqëri aksionare në Obiliq, pasi nga shkresat e lëndës dhe atë nga procesverbali KI.br.132/93 i datës 23.08.1993, nga vendi i ngjarjes i përpiluar nga gjyqtari hetues i Gjykatës Komunale në Prishtinë, nga të dhënat për pjesëmarrësit në aksident theksohet se pjesëmarrës ka qenë autobusi i markës "Fap Sanos", me regjistrim pr...., pronë e Elektro Ekonomisë-Auto Transport nga Obiliqi, për të cilin theksohet se ka qenë krejtësisht i dëmtuar, po ashtu bazuar në vendimin nr.998 të datës 30.03.2001, nxjerrë nga bordi ekzekutiv i Korporatës Energjetike të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 20.03.2001, me të cilin vetë e paditura ka marrë obligimin për pagimin e kompensimit të dëmit familjeve të punëtorëve të EEK tani KEK-ut, të cilët kanë humbur jetën tragjikisht në fatkeqësinë e komunikacionit që ka ndodhur me datën 23.08.1993, në vendkalimin mbi rrugën e trenit Fushë Kosovë-Pejë, në vendin e quajtur Pomazatin, që ka të bëjë me po të njëjtin rast edhe në raport me paditësit dhe të paditurën.

E paditura Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë, ndonëse pretendon se është regjistruar në regjistrin e bizneseve të UNMIK-ut, me datë 06.10.2000 dhe se nuk ka subjektivitet dhe kontinuitet juridik me subjektin e mëparshëm "EPS", ku i ndjeri ka qenë në marrëdhënie pune, është i pa bazë për faktin se është fakt notor që Korporata Energjetike e Kosovës ndonëse është themeluar si subjekt i ri ka poseduar me të gjitha asetet të cilat paraprakisht i ka poseduar Elektro Ekonomia, andaj vetë fakti që ka trashëguar me asetet duhet të merr edhe obligimet të cilat kanë ekzistuar, apo janë krijuar në kohën e ekzistimit të saj si

⁶ Njëjtë,
⁷ njëjtë

subjekt. Vetë e paditura pranon se i ndjeri ka qenë punëtor i Elektro Ekonomisë dhe se Elektro Ekonomia ka pasur të kontraktuar Autotransportin për bartjen e punëtorëve të Elektro Ekonomisë që do të thotë se e drejta e paditësve në kompensim rrjedh edhe nga vetë fakti i raportit kontraktual në mes të Elektro Ekonomisë dhe Autotransportit, duke marr për bazë faktin se tani Autotransporti si ndërmarrje nuk ekziston.

Gjykata e Apelit e konsideron si të pa bazuar pretendimin e palës së paditur se kemi të bëjmë më parashkrim të kërkesave në raport me të paditurën KEK për faktin se paditësit padinë e kanë ushtuar qysh në vitin 1996, ndërsa në bazë të nenit 388 të LMD-së⁸, me vetë ngritjen e padisë ndërpritet parashkrimi.

Gjykata e shkallës të dytë nga të cekurat vendosi sikurse në dispozitiv, në bazë të nenit 195.1 nën pikën d) dhe e) e lidhur me nenin 201, par.1 nën pikën d) të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac. nr.5/2013, më datë 11.03.2016

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Fejzullah Rexhepi

⁸ LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978,